



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI I TIRANËS  
SENATI AKADEMIK

Nr. 474/3 Prot.

Tiranë, më 04.05 2023

VENDIM

Nr. 22, datë 04.05.2023

**“PËR PËRZGJEDHJEN E ANËTARIT, PËRFAQËSUES TË PERSONELIT  
AKADEMIK ME KOHË TË PLOTË, TË FAKULTETIT TË DREJTËSISË, TË  
UNIVERSITETIT TË TIRANËS, NË KOMISIONIN E APELIMIT TË UT-së”**

Bazuar në nenin 37, pika 1 dhe 2, të Rregullores “Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe Senatin Akademik në Universitetin e Tiranës”; në Vendimin nr.14, datë 27.02.2023, të Senatit Akademik të UT-së, “Për fillimin e procedurave dhe miratimin e periudhës së vetkandidimit për anëtarin e Komisionit të Apelit të UT-së, përfaqësues i Fakultetit të Drejtësisë të UT-së”; Senati Akademik të UT-së, në mbledhjen e tij të datës 04.5.2023 pasi kreu procesin e zgjedhjes, mbështetur në Procesverbalin e Komisionit të ngritur nga Senati Akademik për realizimin e këtij procesi,

VENDOSI:

- I. Prof.Asoc.Dr. Kreshnik Myftari, zgjidhet anëtar i Komisionit të Apelit të UT-së, përfaqësues i personelit akademik me kohë të plotë, në Fakultetin e Drejtësisë të UT-së.
- II. Ky Vendim i përcillet për zbatim Komisionit të Apelit të UT-së; për njoftim Fakultetit të Drejtësisë të UT-së, si edhe Prof.Asoc.Dr. Kreshnik Myftari.
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI  
Prof. Dr. Artan Hoxha

